



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 3

Prishtinë, më 26.1.2015, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Salih Salihu, Velimir Rakiq, Emilije Redzepe, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Adem Salihaj.

Mungoi : Murat Hoxha, anëtar nga PDK ende nuk është emëruar.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 20.1.2015,
3. Takimi i komisionit me ministrin e MBPZHR lidhur me planin dhe prioritetet e ministrisë,
4. Shqyrtimi i planit të punës së komisionit për vitin 2015,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.1.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20 janar 2015.

3. Takimi i komisionit me ministrin e MB

Kryetari falënderoj për pjesëmarrje ministrin të bujqësisë të cilin e njoftoj shkurtimisht për arsyet pse është ftuar sot në komision dhe i uroj punë të mbarë, ndërkaq ministri **Memli Krasniqi** i cili gjithashtu uroj kryetarit dhe anëtarëve të komisionit punë të mbarë dhe

bashkëpunim të përafërt me MB. Lidhur me programin legjislativ tha se nuk ka ministria numerikisht shumë ligje të parapara por ka ligje të rëndësishme siç janë ushqimi dhe pylltaria të cilat do të sjellën në Kuvend qysh në muajin mars të këtij viti (kryetari rikujtoi ministrin se sipas strategjisë nga Qeveria këto janë paraparë për nëntor dhe pyeti a mundet komisioni të llogaris për më heret ashtu si tha ministri). Përndryshe, vazhdoi, bujqësia në këtë vit ka marr një relevancë të madhe duke dyfishuar buxhetin (60 milion, 54 prej të cilave subvencione dhe grande) dhe të cilat do të menaxhohen kryesisht nga Agjencia për pagesa (Agjencia për zhvillimin e bujqësisë) e cila ende nuk është pavarësuar në aspektin e kodit financiar, gjithashtu pastaj me rishikim të buxhetit duhet të intensifikohen mundësitë për rritjen e buxhetit për subvencione të fermerëve përkatësisht 39 milionët e mbetura. Donatorët më të rëndësishëm për bujqësi si zakonisht edhe këtë vit do të janë KE, IPA, Agjencia Amerikane për bujqësi, Banka Botërore (DANIDA), Ambasadat bashkëpunuese të shteteve evropiane etj. Sa i përket planit afatshkurtër të ministrisë është hartuar programi për zhvillimin rural ku patjetër do të rritet transparenca me fermerët fitues dhe potencial dhe bazohet në buxhetin aktual të këtij viti, në këtë mënyrë do të rriten mjetet për kultura strategjike siç janë gruri, misri, luledielli...së paku që këto të mbeten në nivelin e njëjtë apo të ketë rritje të rendimenteve, ndërsa për gjedhe parashihet 50 euro për gjedhe, për vreshta, pemishte, fruta (400 euro për hektar), synimi që therjet e gjedheve të legalizohen me subvencion 20 euro (10 euro për thertore të licencuara 10 për fermerin). Grandet do të epen me dy masa të standardeve të BE, masa e ashtuquajtur 101 për prodhim bazik dhe masa 103 për përpunim (ujitje, punësimi etj), ku ministria do të zgjatë afatin e përmbushjes prej 12 muaj në 24 muaj. Për regjistrimin e bujqësisë parashihet që me 28 shkurt të publikohet raporti, të cilin veprim anëtarët e komisionit e kundërshtuan, p.sh. **Adem Salihaj** pyeti çfarë regjistrimi bujqësor është ajo kur anketuesi pyet : a keni tokë dhe a punoni. Në kuadër të politikës pyjore, vazhdoi ministri, do të kthehet menaxhimi qendror sipas kërkesave që janë bërë nga disa komuna, ndërsa për menaxhimin e parqeve nacionale ku ka pyje, do të mirën edhe sugjerimet e këtij komisioni, ministri diskutoi edhe për gjueti dhe vendgjuetitë ilegale të cilat do të legalizohen dhe do të mirëmbahet fondi për ato, ku do të ndalohet gjuajtja e kaprojeve. AVUK parashihet prapë të kthehet në kuadër të ministrisë e jo si ka qenë deri tani si zyre e kryeministrit, që rrallë dikun që është kështu sikurse te ne. Ministri i ceku edhe disa projektligje që do të dërgohen Kuvendit, pijet e forta deri 14%, veterinarinë, inspektoratin sanitar, farërat, materialin fidanor. Në fund falënderoj.

Në kuadër të pyetjeve të anëtarëve të komisionit **Lahi Brahimaj** vuri aksentin në buxhetin shqetësues të ministrisë ku subvencionet dhe grandet deri tani janë shfrytëzuar kryesisht nga militantët e partisë dhe sqaroi me shembuj konkret vështirësitë e fermerëve lidhur me oferta, ndaj pyeti a do të përdorën nga MB kriteret për mbikëqyrje. Në vazhden e kësaj pyetje ai bëri pyetje shtesë pse nuk ka subvencione për ujitje, ngase çka i nevojitet fermerit 100 euro për grurin nëse ai nuk i ka punët mirë me ujitjen. Ai gjithashtu i sqaroi ministrit për shumë probleme teknike siç është dënimi i fermerëve për shkak të ndërrimit të lopëve, djegëjen me qëllim të pyjeve në vendin e caktuar për të shpallur më vonë tenderin për prerje, mosaplikimi i tatimeve për prodhues të rakisë së shpisë (ilegal) ngase ai ka drejt të prodhoi 500 litra për nevojat e shpisë e jo për me shitur nëpër restorante, derisa në anën tjetër prodhuesit legal “prehen me sakicë” nga zyrtarët shtetërorë. **Salih Salihu** u bashkëngjiti pyetjeve të shumta siç tha ai, por ato kryesore sipas tij është jo përgjegjësia, nëse marrim shembull plehun, vazhdoi, ajo futet në vend dhe prapë shitet si vendorë, dhe gjithë kjo punë nga kryeinspektori përcjellët në heshtje, prej 100 kg aty ka vetëm 12 kg pleh aktiv, pyjet prehen askush nuk ndërmerr masa, toka pjellore çdo ditë zvogëlohet, askush nuk ndërmerr masa, regjistrimi i bujqësisë kryhet kur nuk funksionon shteti, uji na shkon duke rrjedhur në Danub për badihava (nuk kemi akumulime), pse një traktor blihet 29.000 euro ndërsa zyrtarët pyesin pse nuk ke blerë 32.000 euro etj etj ndaj pyeti a është kjo politikë e PDK apo LDK dhe sugjeroi të shtyhet për dy vite autostrada për të pasur bujqësia ujë me bollëk, gjithashtu sugjeroi ministrin të ftoi ish ministrin dhe stafin dhe të shikojnë bashkërisht ku kanë mbetur problemet dhe pse, përndryshe 54 milionët e paraparë asgjë nuk do të kontribuojnë për përparimin e bujqësisë. Në fund kishte edhe një kërkesë për ministrinë, për të reklamuar prodhimet vendore sa më shumë. **Adem Salihaj** insistoi në analizën e defekteve të

deritashme të subvencioneve dhe shqyrtimin e aplikacioneve gjatë muajit janar e jo gjatë muajve mars apo prill kur është vllugu i punëve, të sjellen statistikën e importit të prodhimit ushqimor, nëse kemi vetëm 300 milion për prodhim ndërsa importojmë 680 milion si mund të jemi konkurrent me prodhimet tona (Maqedonia 160 milion, ndërsa ne 30 milion). Ne kemi gabime serioze dhe investime në mjegull, vazhdoi, ndaj duhet të fokusohemi në fusha të duhura, të kontrollohet ushqimi që importohet ngase sëmundjet vazhdimisht shtohen dhe zgjerohen madje edhe gjedhët vendor nuk janë të sigurt ngase ushqehen artificialisht sa për tu fryer, si rezultat kemi helmime, në fund kërkoi zgjedhjen e problemit të qeneve endacak urgjent. **Emilija Redzeqi** përkrahu diskutimet rreth konkurrencës jolojale dhe strategjinë dhe u fokusua në kërkesat e bashkësive minoritare në rajonin e Sharrit ngase edhe atje ndodhin migrimet brengosëse të popullatës, gjithashtu ceku funksionimin e disa shoqatave pa mbështetje qeveritare (p.sh. shoqata e gjuetarëve), problemin e mbrojtjes së pyjeve dhe përmirësimin e strategjisë së MB. **Lahi Brahimaj** potencoi edhe problemet teknike me dosjet e ndryshme të fermerëve, p.sh. nuk e ka një dokument, automatikisht eliminohet etj. **Haxhi Shala** pyeti për planifikim të ndarjes së subvencioneve, ngase nuk do të thotë që duhet të epen të holla kesh, mjafton të lirohet nafta për bujq, rimorkio që blihet në Maqedoni p.sh. të konsiderohet pajisje bujqësore etj. **Velimir Rakiq** përkrahu disa sugjerime që u dëgjuan dhe insistoi në shërbimin e veterinarisë dhe gjendjen e gjedhëve, ndërsa për prodhimin e grurit kërkoi angazhimin e veçantë ngase ajo mbjellët edhe në vendet shkëmbore siç është pjesa veriore, por duhet të jetë fara kualitative dhe të shpërndahet nëpër pika grumbulluese.

Ministri **Memli Krasniqi** falënderoi për pyetje dhe u mundua të përgjigjet shkurtimisht duke potencuar punën pa paragjykime, dallime partiake etj. Ai pranoi vërejtjen e z. Brahimaj se ka pasur favorizime partiake të cilat sipas tij duhet të eliminohen gradualisht në favor të bujqve duke aplikuar kriteret : sipërfaqja tokësore dhe kultura. Gabimet nëpër dosje të fermerëve nuk janë të partive por të nivelit komunal (pyetja rreth refuzimit të subvencioneve), aty ka edhe vepra penale me siguri, ndaj ministri apeloi të tregohen këto veprime publikisht pa pardon. Lidhur me oferta, ministri tha se nuk është fans i burokracisë, por në këto raste ajo duhet të forcohet dhe të rritet transparenca, kriteret me siguri janë diskriminues por zhvillimor, kush ka ma tepër tokë ai fiton më tepër subvencione. Për Institucionet tjera tha se duhet koordinim ma i mirë dhe ekzekutim të këtij koordinimi, ndërsa për ujitje duhet një master plan ngase edhe ashtu ajo për shkak të rëndësisë është futur në program, ku do të ndihmohet nga projekti DANIDA. Lidhur me konkurrencë potencoi se Maqedonia e bënë atë ngase ne nuk jemi pjesë e IPARD, ndaj p.sh. verërat , nuk jemi konkurrent as në eksport e mos të flasim për gjëra tjera, konkurrencat e prioritetëve është shumë ma i madh sivjet. Regjistrimi i bujqësisë ka ndodhë kur ka ndodhë dhe nuk është parapa që ngërçi politik do të zgjatë aq shumë, sido që të jetë ai potencoi faktin nëse EUROSTATI jap notën pozitive, duhet të pajtohemi. Ai gjithashtu u fokusua tek plani zhvillimor afatmesëm i cili është i përfunduar por duhet të kaloj përmes Kuvendit, ndërsa statistikën nga terreni do të paraqiten në Librin e gjelbërt dhe do të shpërndahet deputetve një nga një. Rreth qenëve endacak tha se nuk është problem ministror por komunal, gjithashtu për problemet që u potencuan nga z. Brahimaj dhe Salihu, ai premtoi se për produkte do të epen çmimet referente (traktorat p.sh.sa kushtojnë). Ministri i bindur se nuk u përgjigj në të gjitha pyetjet, premtoi një bashkëpunim shumë të përafërt me këtë komision.

4. Plani i punës së komisionit për vitin 2015

Kryetari propozoi ndërsa Komisioni miratoi unanimisht planin e komisionit për vitin 2015 me plotësime që u dëgjuan gjatë raportimit të Ministrit.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka